



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONI RREGULLATOR

V E N D I M

P Ë R

“ MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E  
KOMISIONIT RREGULLATOR”

Komisioni Rregullator, në mbledhjen e tij të datës 26.10.2020, me pjesëmarrjen e:

Ilijana	NANO -	Kryetare
Arens	ÇELA -	Anëtar
Dritan	ÇAKA -	Anëtar
Helga	VUKAJ -	Anëtare
Muharrem	ÇAKAJ -	Anëtar

shqyrtoi çështjen me:

**OBJEKT:** Miratimin e rregullore “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit Rregullator”.

**BAZA LIGJORE:** Neni 15, pika 3, neni 20, pika 1 germa “d”, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

Komisioni Rregullator pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Komisioneri, dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve, në zbatim të nenit 15, pika 3, dhe neni 20, pika 1, germa “d” të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,



## VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit Rregullator”, bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Ilirjana**      **NANO -**

**Kryetare**

**Arens**      **ÇELA -**

**Anëtar**

**Dritan**      **ÇAKA -**

**Anëtar**

**Helga**      **VUKAJ -**

**Anëtare**

**Muharrem**      **ÇAKAJ -**

**Anëtar**





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONI RREGULLATOR**

**RREGULLORE**

**E MBLEDHJEVE TË  
KOMISIONIT RREGULLATOR**

**KREU I  
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1  
Qëllimi dhe objekti i rregullores**

Qëllimi i kësaj rregulloreje është organizimi dhe funksionimi i punës dhe i mbledhjeve të Komisionit Rregullator (më poshtë “Rregullatori”) në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (më poshtë “KQZ”), në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Objekti i kësaj rregulloreje është të përcaktojë rregulla të detajuara për mbledhjet e Rregullatorit në KQZ, mënyrën e funksionimit të Rregullatorit dhe procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të akteve në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar

Kjo rregullore përcakton rregullime në lidhje me:

- a. mënyrën e ushtrimit të kompetencave të Rregullatorit, të drejtat dhe detyrat e Rregullatorit;
- b. rregullimin e marrëdhënieve të administratës me Rregullatorin;
- c. procedurat për thirrjen, njoftimin dhe zhvillimin e mbledhjeve të Rregullatorit;
- d. procedurat e vendimmarrjes së Rregullatorit;
- e. të drejtat dhe detyrimet e përfaqësuesve të subjekteve zgjedhore në mbledhjet e Rregullatorit;
- f. rregullat mbi koordinimin e veprimtarisë administrative me Komisionerin dhe Administratën e KQZ-së.

1



Miratuar me Vendimin e Komisionit Rregullator, nr. 1 datë 26.10.2020 “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit Rregullator ”

## Neni 2

### Ligji dhe parimet në të cilat mbështetet veprimtaria e Komisionit Rregullator

1. Veprimtaria e Rregullatorit mbështetet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, ligje dhe akte nënligjore të veçanta që lidhen me veprimtarinë e tij.
2. Veprimtaria e Rregullatorit bazohet edhe në parimet kushtetuese, parimet e Kodit Zgjedhor dhe parimet e parashikuara në ligjin nr.44/2015 “Kodi i Procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”.

## KREU II

### PËRBËRJA DHE KOMPETENCAT E KOMISIONIT RREGULLATOR

## Neni 3

### Përbërja e Komisionit Rregullator

1. Rregullatori është një nga organet drejtuese të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Ai përbëhet nga 5 anëtarë, nga të cilët njëri ushtron detyrën e kryetarit. Kryetari dhe anëtarët e rregullatorit zgjidhen nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë për një mandat 5-vjeçar, sipas procedurës së përcaktuar në ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar .
2. Rregullatori funksionon me kohë të pjesshme dhe e ushtron veprimtarinë në mbledhje publike, të cilat thirren nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve më poshtë (“KSHZ”). Në rast se KSHZ nuk vë në lëvizje Rregullatorin kur ka çështje të kompetencës së tij, atëherë Rregullatori vetëmblihet me kërkesë të çdo anëtari.

## Neni 4

### Kompetencat e Komisionit Rregullator

1. Rregullatori është organi kompetent për shqyrtimin dhe miratimin e projekt-aktet me karakter normativ, në fushën e zgjedhjeve dhe vendosjen e rregullave normuese për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve, referendumeve si dhe çdo proces që lidhen me zgjedhjet, për:
  - a. rregullat e detajuara për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve dhe referendumeve, detyrat e administratës zgjedhore dhe procedurat që zbatohen në zgjedhje;
  - b. rregullat dhe udhëzimet për njehsimin dhe përmirësimin e praktikave zgjedhore, si dhe për veprimtarinë e institucioneve publike në shërbim të zgjedhjeve;
  - c. rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara përgjatë fushatës, si dhe procedurën e KQZ-së për zbatimin e ndalimit;

2



Miratuar me Vendimin e Komisionit Rregullator, nr. 1 datë 26.10.2020 “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit Rregullator”

- d. rregullat për metodologjinë e monitorimit të medias, për procedurën e shqyrtimit të raporteve dhe për vendosjen e masave qortuese apo ndëshkimore;
  - e. rregulloren e mbledhjeve të Rregullatorit dhe rregulloren e seancave të KAS-it;
  - f. rregullat për regjistrimin e votuesve nga jashtë vendit, për procedurat e tyre të votimit, për administrimin dhe numërimin e votave nga jashtë vendit dhe përfshirjen e tyre në rezultatin e përgjithshëm të zgjedhjeve për Kuvendin;
  - g. llojin dhe karakteristikat teknike që duhet të plotësojnë sistemet apo pajisjet e teknologjisë së informacionit, që prokurohen dhe përdoren në zgjedhje në Republikën e Shqipërisë;
  - h. rregullat për përdorimin e sistemeve apo pajisjeve të teknologjisë së informacionit, të domosdoshme për të siguruar përdorimin e ligjshëm, të rregullt, transparent, efikas dhe të qëndrueshëm të tyre;
  - i. rregullat për raportimin financiar të subjekteve zgjedhore, rolin dhe përgjegjësitë e financierëve të subjekteve zgjedhore, monitorimin dhe auditimin e pavarur të tyre, si dhe për hetimin administrativ të informacioneve, kërkesave, propozimeve, ankesave apo denoncimeve për shkelje lidhur me financimin apo shpenzimet e fushatës;
  - j. rregullat për furnizimin dhe administrimin e materialit zgjedhor;
  - k. udhëzuesit dhe doracakët në shërbim të administratës zgjedhore, subjekteve zgjedhore dhe zgjedhësve;
  - l. tarifatat e shërbimit për organizimin dhe administrimin e proceseve zgjedhore të institucioneve dhe organizmave publike, kur ligji e ngarkon me këtë detyrë;
2. Rregullatori shqyrton dhe miraton projektaktet e përgatitura nga administrata e KQZ së për:
    - a. kufijtë e zonave të administrimit zgjedhor në përputhje me ligjin nr. nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
    - b. numrin e mandateve për çdo zonë zgjedhore për zgjedhjet në Kuvend;
    - c. përdorimin e sistemeve apo pajisjeve të teknologjisë së informacionit për të mbuluar aspekte apo procedura të veçanta të procesit zgjedhor, ose heqjen e tyre nga përdorimi;
    - d. zhvillimin për herë të parë të votimit nga jashtë vendit, mbështetur në raportimin e Komisionerit për plotësimin e masave tekniko-organizative që mundësojnë votimin;
    - e. rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve në shkallë vendi në përputhje me ligjin nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar .
  3. Aktet administrative bazë të Rregullatorit në ushtrimin e detyrës janë vendimet. Vendimet merren kur pro tyre votojnë së paku katër anëtarë, përveç vendimeve sipas shkronjave “b” dhe “e” të pikës 4 të këtij neni, të cilat miratohen me shumicë të thjeshtë.

## Neni 5

### Të drejtat e Kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit Rregullator

1. Kryetari i Komisionit Rregullator:
  - a. cakton datën dhe orën e fillimit të mbledhjes;
  - b. merr masat të koordinojë me Komisionerin për ambientet dhe krijimin e logjistikës së nevojshme për zhvillimin e mbledhjeve, transmetimin e tyre në kohë reale;
  - c. merr masa për njoftimin e anëtarëve të Rregullatorit, përfaqësuesve të partive politike parlamentare, subjekteve zgjedhore dhe personave të tretë sipas rastit;
  - d. drejton mbledhjet e Komisionit sipas rregullave të përcaktuara në këtë rregullore si dhe në ligjin për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike;



- e. merr masa për përcjelljen e vendimeve administratës së KQZ-së për të vijuar me procedurat e administrimit dhe publikimit të tyre.
2. Çdo anëtar dhe Kryetari i Komisionit Rregullator për ushtrimin e funksioneve të veta ka dhe këto të drejta:
- t'i kërkojë çdo informacion, dokumentacion dhe mbështetje administratës së KQZ-së, e cila ka detyrimin të vërë në dispozicion sipas kërkesës, fotokopje të çdo dokumentacioni të depozituar në KQZ;
  - t'i sigurohen nga Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së kushtet për zhvillimin e mbledhjeve të Rregullatorit;
  - të njihet me rendin e ditës së mbledhjes së Rregullatorit dhe me materialet përkatëse:
    - jo më vonë se 48 orë përpara zhvillimit të mbledhjes, për periudhën deri 1 muaj përpara datës së zgjedhjeve;
    - jo më vonë se 24 orë përpara zhvillimit të mbledhjes, për periudhën 1 muaj paradatës së zgjedhjeve, deri në datën e zgjedhjeve;
    - sipas rastit jo më vonë se 2 orë përpara zhvillimit të mbledhjes për ditën e zgjedhjeve deri në shpalljen e rezultatit, për çdo zonë zgjedhore.
3. Në rast se Komisioneri nuk vë në lëvizje Rregullatorin kur ka çështje të kompetencës së tij, atëherë Rregullatori vetëmbledhet me kërkesë të çdo anëtari. Në këto raste Kryetari i Rregullatorit ka detyrimin të thërrasë mbledhjen, të caktojë ditën dhe orën e zhvillimit të saj në përputhje me afatet e parashikuara në paragrafin 2 shkronja "c" të këtij neni. Nëse Kryetari i Rregullatorit nuk përmbush detyrimin e mësipërm, mbledhja thirret dhe drejtohet nga anëtari propozues.

## Neni 6

### Detyrat e Kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit Rregullator

Kryetari dhe Anëtarët e Komisionit Rregullator, duhet:

- Të mos ushtrojnë njëkohësisht detyra të tjera brenda organeve, institucioneve apo enteve, pjesë e pushtetit ekzekutiv;
- Të zbatojnë dhe të respektojnë normat e njohura dhe të gjithëpranuara të etikës në komunikim dhe sjellje.

## Neni 7

### Administrata e KQZ-së

Për funksionimin dhe përmbushjen e detyrave që burojnë nga Kodi Zgjedhor, Komisioni Rregullator mbështetet dhe asistohet nga administrata e KQZ-së.



**KREU III**  
**Përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore**

**Neni 8**  
**Regjistrimi në KQZ i përfaqësuesve të subjekteve zgjedhore**

1. Në përputhje me përcaktimet e bëra në nenin 26 të Kodit Zgjedhor, partitë politike ose koalicionet e partive politike, që regjistrohen për të marrë pjesë në zgjedhje, nëpërmjet personit përgjegjës për komunikimin me KQZ-në, mund të caktojnë me autorizim një përfaqësues dhe një zëvendës të tij pranë KQZ-së, me tagra përfaqësimi për gjithë periudhën deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar. Përfaqësuesit e partive parlamentare i ushtrojnë tagrat e përfaqësimit edhe jashtë periudhës së përcaktuar në fjalinë e parë të kësaj pike.
2. Të dhënat për përfaqësuesit e subjekteve të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni mbahen dhe përditësohen në një regjistër të posaçëm, i cili administrohet nga Protokolli i KQZ. Një kopje e këtij regjistri ju dërgohet anëtarëve të Komisionit Rregullator si dhe administratës së KQZ-së.
3. Përfaqësuesit e subjekteve të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni pajisen me dokumentin përkatës të identifikimit, sipas modelit të miratuar nga Komisioneri apo nëpunësi i deleguar prej tij.

**Neni 9**  
**Akti i përfaqësimit**

Përfaqësuesit e subjekteve të përcaktuara në paragrafin 1 të nenit 8 të kësaj rregulloreje, dhe zëvendësuesit e tyre, depozitojnë në KQZ, aktin e përfaqësimit (prokurë të posaçme ose autorizim) të nënshkruar nga kryetari i partisë ose drejtuesi i subjektit zgjedhor.

**Neni 10**  
**Të drejtat dhe detyrat e përfaqësuesve të subjekteve zgjedhore dhe të partive parlamentare gjatë mbledhjeve të Rregullatorit**

1. Përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore dhe të partive parlamentare në Rregullator gëzojnë të drejtat e parashikuara në paragrafin 2 të nenit 26 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.
2. Në rast se, në mbledhje të Rregullatorit marrin pjesë njëkohësisht përfaqësuesit e subjekteve të përcaktuara në paragrafin 1 të nenit 8 të kësaj rregulloreje dhe zëvendësit e tyre, të drejtën e fjalës, kur legjitimohet, e ka vetëm njëri prej tyre.
3. Në çdo rast çështja që diskutohet duhet të ketë lidhje me zgjedhjet dhe objektin e projektaktit që parashtrohet për shqyrtim.
4. Përfaqësuesve të subjekteve të përcaktuara në paragrafin 1 të nenit 8 të kësaj rregulloreje u vihen në dispozicion materialet e rendit të ditës së mbledhjes së thirrur duke i dërguar pranë selive të partive, me postë elektronike sipas të dhënave të deklaruara apo duke ua venë në dispozicion në



ambientet e KQZ-së. Në çdo rast, Përfaqësuesit e partive të tjera kanë të drejtë t'i tërheqin ato pranë Sekretarit të Përgjithshëm ose Protokollit të KQZ-së.

5. Përfaqësuesit e partive politike kanë të drejtë të marrin një kopje të akteve të Rregullatorit pranë zyrës së Protokollit.
6. Përfaqësuesit e subjekteve të përcaktuara në paragrafin 1 të nenit 8 të kësaj rregulloreje janë të detyruar të respektojnë rregulloren e Rregullatorit, si dhe etikën e mbledhjeve dhe të komunikimit. Në rast të thyerjes së tyre merren masat e parashikuara në rregullore.

## KREU IV MBLEDHJET E KOMISIONIT RREGULLATOR

### Neni 11 Thirrja, njoftimi dhe përgatitja e mbledhjes

1. Mbledhjet e Rregullatorit thirren, njoftohen dhe përgatiten sipas përcaktimeve të bëra në nenet 19 dhe 20 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë dhe të kësaj rregulloreje.
2. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vë në lëvizje mbledhjen e Rregullatorit. Njoftimi i mbledhjes hartohet në tre kopje. Ai përmban propozimin për rendin e ditës, projektaktet e propozuara, relacionet shoqëruese të projektakteve si dhe çdo dokument tjetër të lidhur me aktet.
3. Si rregull, jo më vonë se 24 orë nga data e regjistrimit të njoftimit të mbledhjes Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së i dërgon aktin së bashku me praktikën dokumentare përkatëse Kryetarit dhe anëtarëve të Rregullatorit si dhe subjekteve të përcaktuara në paragrafin 1 të nenit 8 të kësaj rregulloreje. Dërgimi bëhet nëpërmjet postës elektronike dhe/ose në formë shtypi(print). Kur është rasti sa më sipër ju dërgohet edhe të tretëve të tjerë që kanë interes në çështje.
4. Njoftimi për mbledhje është publik
5. Kryetari i Rregullatorit në zbatim të nenit 5, paragrafi 1 të kësaj rregulloreje cakton datën dhe orën e fillimit të mbledhjes.
6. Në rastet kur mbledhja nuk është vënë në lëvizje nga Komisioneri sipas nenit 19, pika "c" e Kodit Zgjedhor, kopje të njoftimit dhe të akteve sipas paragrafit 2 të këtij neni, i dërgohen paraprakisht KSHZ. Akti i nënshkruar regjistrohet nga anëtari propozues rregjistrohet në protokoll dhe më pas, i dërgohet Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ-së, i cili merr masa për njoftimin e anëtarëve të Rregullatorit, përfaqësuesve të subjekteve të përcaktuara në paragrafin 1 të nenit 8 të kësaj rregulloreje dhe medias.
7. Kopje e aktit të thirrjes së mbledhjes vendoset në vendin e posaçëm në hyrje të KQZ-së, si dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së në internet.
8. Mbledhjet e Komisionit Rregullator, thirren sipas afateve të mëposhtme:
  - a. jo më vonë se 48 orë përpara zhvillimit të mbledhjes, për periudhën deri 1 muaj përpara datës së zgjedhjeve;
  - b. jo më vonë se 24 orë përpara zhvillimit të mbledhjes, për periudhën 1 muaj para datës së zgjedhjeve, deri në datën e zgjedhjeve;
  - c. sipas rastit jo më vonë se 2 orë përpara zhvillimit të mbledhjes për ditën e zgjedhjeve deri në shpalljen e rezultatit, për çdo zonë zgjedhore.

6



Miratuar me Vendimin e Komisionit Rregullator, nr. 1 datë 26.10.2020 "Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit Rregullator "



## Neni 12

### Thirrja dhe njoftimi i mbledhjes së Rregullatorit, nga dekretimi i datës së zgjedhjeve deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar

1. Rregullatori mblidhet sipas afateve të përcaktuara në nenin 11 i kësaj Rregulloreje, për periudhën nga dekretimi i datës së zgjedhjeve deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve.
2. Në raste të veçanta, gjatë periudhës 1 muaj para datës së zgjedhjeve deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve, Rregullatori mund të mblidhet sa herë të jetë e nevojshme.

## Neni 13

### Thirrja dhe njoftimi i mbledhjes së Rregullatorit, pas shpalljes së rezultatit përfundimtar

1. Jashtë periudhës së përcaktuar në nenin 12 të kësaj rregulloreje, Rregullatori mblidhet jo më pak se 1(një) herë në muaj.
2. Mbledhja e Rregullatorit e thirrur sipas parashikimit të paragrafit 1 të këtij neni bëhet jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga kërkesa për vënien në lëvizje nga Komisioneri, apo anëtarët e Rregullatorit.

## Neni 14

### Përmbajtja e dosjes së materialeve për mbledhjen e Rregullatorit

1. Për çdo çështje që do të shqyrtohet në mbledhjen e Rregullatorit, materiali përkatës si rregull duhet të përmbajë:
  - a. projektaktin/projektaktet;
  - b. relacionin shpjegues;
  - c. materialet mbështetëse sipas rastit;
  - d. propozimet për ndryshime apo shtesa nga subjektet zgjedhore, nëse ka të tilla, sipas nenit 15 të kësaj rregulloreje;
  - e. deklarimi i qenies ose jo i konfliktit të interesit nga ana e anëtarëve.
2. Në relacionin shpjegues përfshihen arsyet dhe/ose shkaqet përse kërkohet shqyrtimi i çështjes përkatëse në rendin e ditës, qëllimi dhe sipas rastit vlera e shpenzimeve financiare që kërkon zbatimi i këtij akti. Në materialin mbështetës përfshihen, akte, raporte, informacione, etj, të cilat mbështesin relacionin shpjegues.

## Neni 15

### Dorëzimi në Rregullator i propozimeve për ndryshime dhe shtesa në projektaktet dhe materialet e mbledhjes

1. Përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore kanë të drejtë të paraqesin propozime me shkrim apo me gojë, për ndryshime apo shtesa në projektaktet që do të shqyrtohen në mbledhjen e radhës së Rregullatorit.
2. Propozimet për ndryshime dhe shtesa të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, kur janë me shkrim, duhet të depozitohen zyrtarisht në zyrën e protokollit të KQZ.
3. Përveç rasteve kur propozimi është vetëshpjegues, ai mund të shoqërohet me një shënim shpjegues për të lehtësuar të kuptuarit apo sqaruar më mirë qëllimin e propozimit.

7



Miratuar me Vendimin e Komisionit Rregullator, nr. 1 datë 26.10.2020 "Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit Rregullator"

## Neni 16

### Përgatitja e materialeve për mbledhjet që thirren nga një anëtar i Rregullatorit

1. Në rastin kur mbledhja thirret nga një anëtar i Rregullatorit, administrata e KQZ-së duhet të mbështesë anëtarin propozues për hartimin e materialeve të mbledhjes. Me anëtarin propozues Administrata e KQZ-së është e detyruar të bashkëpunojë për të respektuar afatet e njoftimit të mbledhjes sipas kësaj rregulloreje.
2. Materialet e mbledhjes, kërkesa për t'u vetëmbledhur, njoftimi i thirrjes së saj, hartohet sipas parashikimeve të kësaj Rregulloreje. Menjëherë pas regjistrimit në protokoll, i dërgohen Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, i cili ngarkon Sekretarin e Përgjithshëm të KQZ-së, për të marrë masa për njoftimin e anëtarëve të Rregullatorit, përfaqësuesve të subjekteve të përcaktuara në paragrafin 1 të nenit 8 të kësaj rregulloreje dhe medias.

## Neni 17

### Përgatitja e materialeve të mbledhjes të Rregullatorit

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ngarkon Administratën e KQZ-së për përgatitjen e materialeve për çdo mbledhje të Rregullatorit. Administrata e KQZ-së është përgjegjëse për përgatitjen e materialeve.
2. Komisioneri përfaqëson vetë ose nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ-së projektaktin e propozuar për miratim në mbledhjen e Rregullatorit.
3. Në çdo rast Rregullatori mund të thërrasë për shpjegime zyrtarë të tjerë të administratës së KQZ.

## Neni 18

### Dosja e materialeve të mbledhjes

1. Për çdo çështje të rendit të ditës përgatitet një dosje e veçantë nga Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së, apo anëtari i Komisionit Rregullator i asistuar nga administrata e KQZ-së për projektaktet e propozuara prej tij, e cila përveç materialeve të parashikuara në paragrafin 1 të nenit 14 të kësaj rregulloreje, përmban pasqyrën e të dhënave mbi çështjen.
2. Dosja me materialet e mbledhjes, sipas paragrafit 1 të nenit 14 të kësaj rregulloreje, mbahet sipas rastit nga struktura e administratës që ka përgatitur projektaktin, deri në miratimin me vendim nga Rregullatori. Pas miratimit me vendim dosja depozitohet në Zyrën e Regjistrimit të Akteve dhe Dokumentacionit (Protokoll). Në rastin kur materialet janë përgatitur nga anëtarë të Rregullatorit, dosja përkatëse mbahet nga Sekretari i Përgjithshëm. Pas miratimit me vendim, dosja depozitohet në Zyrën e Regjistrimit të Akteve dhe Dokumentacionit (Protokoll).



**Neni 19**  
**Ruajtja dhe administrimi elektronik i materialeve të mbledhjes**

1. Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për procesin e ruajtjes dhe administrimit të materialeve të mbledhjes edhe në formatin elektronik, në versionin përfundimtar, përpara se të shqyrtohen në mbledhjen përkatëse të Rregullatorit.
2. Në çdo rast së bashku me njoftimin për mbledhjen, në faqen zyrtare të KQZ-së, publikohen edhe materialet e mbledhjes.
3. Materialet e mbledhjes, ruhen në një bazë elektronike të dhënash, rregullave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për arkivat.

**Neni 20**  
**Zhvillimi i mbledhjes së Komisionit Rregullator**

1. Anëtarët e Rregullatorit paraqiten në datën dhe orën kur është njoftuar mbledhja, në sallën e mbledhjeve të KQZ-së.
2. Në fillim të mbledhjes, Kryetari deklaron mbledhjen të hapur, paraqet rendin e ditës dhe anëtarët pjesëmarrës në mbledhje, drejton diskutimet, pezullon dhe mbyll mbledhjen e Rregullatorit.
3. Në periudhën 1 muaj para datës së zgjedhjeve deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar, në rast se mungon kuorumi për zhvillimin e mbledhjes, ajo shtyhet për jo më shumë se 12 orë.
4. Jashtë periudhës së përcaktuar në paragrafin 3 të këtij neni, në rast se mungon kuorumi për zhvillimin e mbledhjes, ajo shtyhet për jo më vonë se pas tre ditësh.
5. Mbledhjet e Rregullatorit janë publike dhe zëdhënësi i KQZ-së merr masa për njoftimin e mediave.
6. Në rastet e masave të jashtëzakonshme që mund të vendosen për shkak të gjendjes së jashtëzakonshme, gjendjes së fatkeqësisë natyrore apo situatave të pandemive, mbledhjet e komisionit mund të zhvillohen edhe në distancë nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik. Kryetari i Rregullatorit në bashkëpunim me administratën bën të mundur përgatitjen e infrastrukturës.

**Neni 21**  
**Rregulla të përgjithshme për pjesëmarrësit e tjerë në mbledhje**

1. Përpara fillimit të mbledhjes, Kryetari i Komisionit Rregullator i asistuar nga Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së merr masa për caktimin e vendeve të pjesëmarrësve në mbledhje.
2. Gjatë zhvillimit të mbledhjes ndalohet ndërprerja e fjalës së folësit.
3. Ndalohet marrja e fjalës pa leje, përdorimi i celularëve dhe pirja e duhanit.
4. Pjesëmarrësit në mbledhjet e Rregullatorit duhet të respektojnë rregullat e etikës dhe të komunikimit.



## Neni 22

### Masat për shkelje të rregullave në zhvillimin e mbledhjes së Rregullatorit

1. Kryetari i Rregullatorit është përgjegjës për mbajtjen e rregullit dhe siguron respektimin e kësaj rregulloreje.
2. Në rastet kur çënohen rregullat mbi zhvillimin e mbledhjes, kryetari i saj vendos pezullimin e mbledhjes, për 10 deri në 30 minuta.
3. Në rast se përfaqësuesit e subjekteve të parashikuara në nenin 8, pika 1, paragrafi 1 të kësaj rregulloreje, çënojnë rregullat për zhvillimin e mbledhjeve, kryetari i tërheq vëmendjen secilit që shkakton një gjë të tillë.
4. Në rast se ndonjë nga personat e tjerë të pranishëm në mbledhjet e Rregullatorit prishin rregullin, kryetari mund të vendosë largimin e tij nga salla e mbledhjeve të Rregullatorit.
5. Në rast se zhvillimi i mbledhjes është i pamundur, Rregullatori pa debat dhe në unanimitet vendos për kohën e rifillimit të mbledhjes.

## Neni 23

### Diskutimi për çështje jashtë rendit të ditës

1. Në fillim të mbledhjes, pasi ka prezantuar rendin e ditës Kryetari verifikon kuorumin e nevojshëm të anëtarëve të Rregullatorit, sipas nenit 20, pika 3 të Kodit Zgjedhor. Pasi kryen këto veprime, Kryetari, pyet pjesëmarrësit nëse kanë diskutime për çështje që nuk janë përfshirë në rendin e ditës duke regjistruar sipas rastit folësit.
2. Pasi mbyllet regjistrimi i folësve, drejtuesi jep fjalën sipas radhës së regjistrimit.
3. Folësit e regjistruar kanë të drejtë të flasin vetëm një herë dhe për një kohë jo më të gjatë se 5 (pesë) minuta.
4. Pas përfundimit të diskutimeve të regjistruara, asnjë prej pjesëmarrësve nuk mundet të kërkojë dhe të marrë fjalën për çështje që nuk janë përfshirë në rendin e ditës.

## Neni 24

### Radha e shqyrtimit të çështjeve në mbledhje

1. Radha e shqyrtimit të çështjeve në mbledhjen e Rregullatorit është ajo e përcaktuar në rendin e ditës.
2. Rregullatori me dakordësi mund të vendosë për ndryshimin e radhës së shqyrtimit të çështjeve në rendin e ditës.
3. Me kërkesë të një anëtar, Rregullatori, me votim me shumicë të cilësuar, përfshin në rendin e ditës edhe akte të tjera që plotësojnë kushtet për t'u shqyrtuar në mbledhje të Rregullatorit ose shtyrjen e shqyrtimit të një akti në mbledhjen më të afërt.



## Neni 25

### Pjesëmarrësit që kanë të drejtë të diskutojnë në mbledhjet e Rregullatorit

1. Në mbledhjet e Rregullatorit kanë të drejtë të diskutojnë dhe të japin mendime, vetëm anëtarët e Rregullatorit, dhe sipas rastit, përfaqësuesit e subjekteve të përcaktuar në nenin 8, paragrafi 1 të kësaj rregulloreje, për çështjet që ata kanë interes të ligjshëm, dhe me leje të kryetarit, edhe administrata e KQZ-së, pjesëmarrëse në mbledhje si dhe persona të tjerë që lidhen me përgatitjen dhe administrimin e zgjedhjeve.

## Neni 26

### Shqyrtimi në mbledhjet e Rregullatorit

1. Shqyrtimi i akteve fillon me paraqitjen e relacionit nga Komisioneri ose Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së, ndërsa në rastin kur projektakti është përgatitur nga të paktën një anëtar i Rregullatorit, relacioni paraqitet prej tij/ tyre. Relacioni paraqitet në mënyrë të përmbledhur.
2. Pas relatimit, çdo anëtar i Rregullatorit dhe pjesëmarrësit e tjerë që kanë interes legjitim për çështjen, kanë të drejtë të bëjnë pyetje për të kërkuar sqarime, për elementë të ndryshëm të relacionit.
3. Pjesëmarrësit që dëshirojnë të bëjnë pyetje shprehin paraprakisht kërkesën për të bërë pyetje.
4. Kryetari i Rregullatorit, u jep së pari fjalën anëtarëve dhe më pas përcakton radhën e pjesëmarrësve të tjerë për të bërë pyetje.
5. Gjatë dhënies së përgjigjeve ndalohen ndërprerjet e fjalës të atij që përgjigjet dhe jep komentet.
6. Me miratimin e Kryetarit pjesëmarrësit e tjerë mund të bëjnë edhe një pyetje tjetër si reagim për përgjigjen e marrë.

## KREU V

### DISKUTIMET DHE VOTIMI

## Neni 27

### Votimi në parim dhe hapja e diskutimeve

1. Pas procedurës së parashikuar në nenin 26, kryetari propozon miratimin në parim të projektaktit nëse akti që do të miratohet është akt normativ dhe sipas rastit hap diskutimin për shqyrtimin nën për nen.
2. Kryetari fton anëtarët dhe më pas pjesëmarrësit e tjerë për diskutime për projektaktin.

## Neni 28

### Diskutimet nën për nen

1. Gjatë shqyrtimit nën për nen, e marrin të parët fjalën përfaqësuesit e subjekteve të përcaktuar në nenin 8, paragrafi 1 dhe më pas anëtarët e Rregullatorit. Në përfundim të diskutimeve të subjekteve të përcaktuar në paragrafin 1, neni 8 të kësaj rregulloreje, diskutojnë anëtarët e Rregullatorit. Pas diskutimit të fundit të Kryetarit të Rregullatorit, bëhet mbyllja e diskutimeve.



**Neni 29**  
**Mbyllja e diskutimeve**

1. Mbyllja e diskutimeve bëhet nga Kryetari, me pëlqimin e anëtarëve të Rregullatorit.
2. Të drejtën e propozimit për mbylljen e diskutimeve e ka çdo anëtar i Rregullatorit.
3. Para votimit të çdo propozimi, anëtar i Rregullatorit ka të drejtën e diskutimit për të, për jo më shumë se 5 minuta.

**Neni 30**  
**Votimi i propozimeve për projektaktet që shqyrtohen në mbledhje të Rregullatorit**

1. Në shqyrtimin e projektaktit, Rregullatori voton për përmbajtjen e çdo neni ose pjesë të tij, sipas rastit.
2. Në çdo rast, varianti i projektaktit do të votohet në tërësi, vetëm pasi të jenë votuar propozimet përfaqësuesve të partive politike dhe anëtarëve të Rregullatorit, sipas radhës së propozimit të tyre.
3. Kryetari në përfundim të votimit shpall rezultatin e votimit.

**Neni 31**  
**Votimi**

1. Votimi në Komisionin Rregullator është i hapur. Votimi i hapur bëhet me ngritjen e dorës ose me deklaram.
2. Anëtar i Rregullatorit voton "pro" ose "kundër", Abstenimi nuk lejohet. Me kërkesën e tij, anëtar i ka të drejtë të shpjegojë votën "kundër".
3. Vendimet merren kur pro tyre votojnë së paku katër anëtarë, përveç vendimeve sipas shkronjave "b" dhe "d" të pikës 2 të nenit 20 të Kodit Zgjedhor, të cilat miratohen me shumicë të thjeshtë.

**Neni 32**  
**Regjistrimi i mbledhjeve të Rregullatorit**

1. Të gjitha mbledhjet e Rregullatorit regjistrohen elektronikisht me zë, kur është e mundur edhe me figurë. Për çdo mbledhje mbahet procesverbal, i cili përmban datën dhe vendin e mbledhjes, anëtarët e Rregullatorit që morën pjesë, çështjet që u diskutuan, një përmbledhje e diskutimeve, vendimet e marra, si dhe mënyra dhe rezultati i votimeve.
2. Procesverbali i mbledhjes i pazbardhur dhe i mbajtur i përmbledhur me dorë nga Stenografi, dorëzohet menjëherë në Zyrën e Ruajtjes dhe Administrimit të Dokumentacionit në KQZ.
3. Regjistrimet e mbledhjes së Rregullator ruhen në Arkiv, sipas procedurave të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
4. Gjatë periudhës zgjedhore, anëtarëve të Rregullatorit në pamundësi të vënies në dispozicion të procesverbalit të zbardhur të mbledhjes, përpara nënshkrimit të aktit u vihet në përdorim regjistrimi elektronik i mbledhjes, në të cilën është diskutuar materiali apo akti, nëse kjo kërkohet prej tyre.



**Neni 33**  
**Forma e aktit**

1. Akti i miratuar nga Rregullatori, sipas shtojcës 1, pjesë e kësaj rregulloreje, është i formës së shkruar dhe si rregull përmban:
  - a. Stemën e Republikës së Shqipërisë;
  - b. Emrin e institucionit (KQZ)
  - c. Emrin e organit që nxjerr aktin (Komisioni Rregullator)
  - d. Titullin e aktit;
  - e. Bazën ligjore;
  - f. Pjesën arsyetuese, sipas rastit;
  - g. Pjesën urdhëruese sipas rastit
  - h. Të drejtën e ankimit
  - i. Emrat e anëtarëve që kanë marrë pjesë në votim;
  - j. Logon e KQZ-së;
  - k. Numrin, datën dhe orën e miratimit;
  - l. Mënyrën e votimit të secilit anëtar (pro/kundër)
2. Akti nënshkruhet nga anëtarët që kanë votuar.
3. Çdo akt mund shoqërohet sipas rastit me mendimin pakice ose mendim paralel

**Neni 34**  
**Nënshkrimi i aktit**

1. Akti hartohet në 3 kopje dhe nënshkruhet nga kryetari dhe anëtarët e Rregullatorit. Nënshkrimet e anëtarëve të Rregullatorit vendosen edhe në lidhjet bashkëngjitur aktit të miratuar.
2. Anëtarët e Rregullatorit e nënshkruajnë aktin dhe, në rast se nuk janë dakord me pjesën arsyetuese të tij, mund të paraqesin mendim paralel.
3. Zbardhja e akteve të miratuara bëhet jo më vonë se 24 orë gjatë periudhës zgjedhore dhe jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune gjatë periudhës jo zgjedhore.

**KREU VI**  
**DOKUMENTACIONI I RREGULLATORIT**

**Neni 35**  
**Regjistrimi i akteve dhe i dokumentacionit të Komisionit Rregullator**

1. Regjistrimi i akteve dhe dokumenteve bëhet në regjistrat e poshtëshënuar:
  - a. Regjistër i korrespondencës;
  - b. Regjistër i vendimeve të Rregullatorit;
2. Administrimi i regjistrave bëhet nga administrata e KQZ-së.

**Neni 36**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.

13



Miratuar me Vendimin e Komisionit Rregullator, nr. 1 datë 26.10.2020 "Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit Rregullator"